



“Çështja shqiptare”; e ardhmja e Kosovës preokupon politiken europiane. Pse ndodhin gjithnjë e në mënyrë të përsëritur përleshje të dhunshme? Çfarë roli luan këtu shteti shqiptar që ka lindur më 1912, mbas fundit të Perandorisë Osmane, por që përfshin vetëm gjysmën e të gjithë shqiptarëve? Dhe çfarë rëndësie ka fakti që shqiptarët janë populli i Europës me shumicën më të madhe myslimane? Për herë të parë, libri që keni në dorë paraqet historinë e të gjithë shqiptarëve në Europën Juglindore, në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi. Për shumë vite, nën diktaturën e Enver Hoxhës, Shqipëria ishte e izoluar nga e gjithë bota. Nga viti 2008, me Shqipërinë dhe Kosovën ka dy shtete shqiptare e që të dy ndeshen me probleme të rënda politike dhe ekonomike. Shqiptarët sot gjithnjë e më shumë shtrojnë pyetjen se kujt i përkasin: Lindjes islamike apo Perëndimit europian.

OLIVER JENS SCHMITT është profesor për historinë e Europës Juglindore në Universitetin e Vjenës.

Shoqëruar me një hartë nga Peter Palm


OLIVER JENS SCHMITT

Shqiptarët

Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit

Përkthyer nga ARDIAN KLOSI



traduki 

© Copyright of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

Botimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, një rrjet ndërkombëtar, të cilit i përketin Ministria Federale për Çështje europiane e ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale Gjermane, Fondacioni kulturor zviceran Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer, Agjencia sllovene e Librit JAK dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë.

Titulli i originalit: Die Albaner

Eine Geschichte zwischen Orient und Okzident

Copyright © Verlag C.H.Beck oHG, München 2012

© Të gjitha të drejtat e botimit në gjuhën shqipe i takojnë K&B

Redaktor: Sejdin Cekani

Korrektore: Elsa Demo

Ballina dhe fotot në kopertinë: Jutta Benzenberg

Designer: Vlash Papa

Përpunimi grafik: Greta Konomi

ISBN 978-99943-0-289-5

Shtypur në Shtypshkronjën "Guttenberg"

Tiranë, 2012

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", nr. 41 pranë Universitetit
"Marin Barleti", godina nr. 4, Tiranë.

Tel. - fax.: 00355 4 2249 944

E-mail: info@botimedudaj.com

Website: www.botimedudaj.com



Përkthimin që keni në dorë, Ardian Klosi e kishte përfunduar pak para vdekjes së tij tragjike. Me vdekjen e tij, Shqipëria ka humbur një nga mendimtarët e saj më të mirë dhe më kurajozë, kurse unë një mik. Jam shumë i pikëlluar që këtë libër, si fryt i bashkëpunimit tonë, nuk munda ta prezantoja bashkë me të para lexuesit shqiptar. Por jam i bindur se fryma kritike dhe kontributi për një shoqëri civile demokratike, për të cilën Ardiani ishte angazhuar gjatë gjithë jetës së tij e duke u përballur me një rezistencë të fortë, ka vjelë dhe do të vjelë frytet e saj. Ardiani i ka dashur vendin e tij dhe qytetarët e vendit të tij dhe kishte dhuntinë që t'ua përcillte këtë dashuri të tjerëve. Ishte një dashuri kritike e që nuk pranohej lehtë, se Shqipëria nuk mundi të qeverisej më mirë, se njerëzit e saj nuk mundën të jetonin një jetë më të mirë, se thesaret e kulturës dhe të mjedisit nuk mundën të trajtoheshin më mirë.

Ardian, përmbajtja e këtij libri që ke përkthyer vetë, të kushtohet Ty.

Përmbajtja e lëndës

Pak fjalë në hyrje	9
Bazat e historisë shqiptare	13
Kur fillon historia e shqiptarëve?	19
Periodizimi i historisë shqiptare	21
Alban apo shqiptar?	22
Historia shqiptare në hapësirë: rrudhje apo madhësi e ndryshueshme?	24
“Shqipëria” si koncept hapësinor - ose si quhet vendi i banuar prej shqiptarëve?	27
Historia shqiptare jashtë “Shqipërisë”	28
Kwadri natyror i historisë shqiptare	29
Historia shqiptare në një hapësirë të disafishtë kufitare	36
Gjuha shqipe si pasqyrë e historisë shqiptare	39
Autoktonë apo migrantë?	41
Shqiptarë, sllavë dhe bizantinë në mesjetën e hershme	49
Ngritja e sundimeve sllave në Ballkanin Jugperëndimor	52
Simbioza shqiptare-sllave në mesjetë	54
Sundimi dhe politika në historinë shqiptare	56
Shpalosja e historisë shqiptare në hapësirën sundimtare e kulturore bizantine	56
“Moti i madh”	59
Sundimi i sulltanëve	63
Shërbëtorë besnikë të zotërinjve të tyre?	68
Shqiptarët myslimanë në Perandorinë Osmane	68
Njerëz të pushtetshëm në Arnavut-ilin osman	71
Osmanët dhe malet	75
Një shtet që kërkon të modernizohet dhe kufijtë e fuqisë së tij	77

Shoqëria dhe botët brenda saj	82
Bashkësia dhe grupi gjinor.....	82
Fisi dhe fara - fiset dhe lidhjet farefisnore	86
Nderi dhe mikpritja - e drejta zakonore shqiptare.....	89
Shoqëria dhe botët e ultësirës	93
Me Frang Bardhin në botën fshatare të Shqipërisë së Veriut	96
Lindja e pronës së madhe mbi tokën.....	99
Bota e qyteteve	101
Me Evlija Çelebiun nëpër Arnavut-ili.....	108
Botët e besimit	111
Botët e ortodoksisë	112
Bota e ngushtë e katolikëve shqiptarë	118
Si u kthyen shqiptarët në një shoqëri me shumicë myslimane	120
Midis Umës dhe Ballkanit Perëndimor mysliman: botët myslimane ..	127
“Vendi i dervishëve”	129
Forma të përziera fetare.....	131
Harmoni fetare apo bashkëjetesë e tensionuar?	133
Historia shqiptare si histori migrimesh (deri rreth vitit 1900)	136
Për te kombi nëpër një rrugë të drejtë?	151
Shteti dhe kombi (1912-1945)	168
Bashkimi i shkurtër: Fuqitë e Boshtit dhe	180
“Shqipëria e Madhe” gjatë Luftës së Dytë Botërore	180
Dy rrugë për në komunizëm	182
Epilog: dy shtete shqiptare - shoqëri transterritoriale shqiptare (2011) ..	199
Udhëzime për literaturën shpjeguese.....	205

Pak fjalë në hyrje

Me “çështjen shqiptare” po merren prej vitesh media dhe politika. Në shumë vende europiane shqiptarët si migrantë janë bërë një realitet social. Megjithatë për historinë e shqiptarëve dihet pak, sado që ekziston një traditë e gjatë kërkimore e sidomos në hapësirën e gjuhës gjermane. Çfarë përpjetet të arrijë “Historia e shqiptarëve” që keni përpara dhe çfarë nuk ofron ajo? Këtu lexuesi nuk do të gjejë një doracak gjithëpërfshirës, as ndonjë analizë të hollësishme të historisë së re, pasi kjo mund të gjendet lehtë në një numër studimesh të kohëve të fundit. Synim i këtij libri është në të vërtetë ravijimi i zhvillimeve thelbësore në sundim, shoqëri dhe kulturë; vendosja e historisë shqiptare në një kuadër të Ballkanit, Europës, por edhe të Lindjes së Afërme; para së gjithash, që larmia dhe pasuria e historisë shqiptare të bëhet e lexueshme përmes disa shembujsh përfaqësues. Në këtë mënyrë, interpretimi qëndron krahas pasazheve që qëllimisht janë më fort tregimtare. Hapësira e kufizuar e çon tekstin herë-herë pranë esesë historike. Autori shpreson që ravijimi i qartë në interpretim të ekuilibrojë përqendrimin e detyruar tek thelbësorja. Nacionet “Lindje” dhe “Perëndim”, të përdorura në titull, nuk duhen kuptuar në mënyrë thelbësore - ato veç shënjojnë një fushë tensioni në të cilën lëviz deri më sot historia shqiptare.

Shumë pjesë të historisë shqiptare janë të diskutueshme në interpretimin e tyre. Për këtë shkak, në disa kapituj paraqiten

metodat dhe argumentet e hulumtimit shkencor dhe më pak njohuri të sigurta.

Konceptimi i botuesit nuk parashikon shpjegues, por vetëm një bibliografi të shkurtër. Ndaj këtu po përmendim emrat e dijetarëve, mbi veprat e të cilëve mbështetet në thelb paraqitja jonë: Peter Bartl, Nuri Bexheti, Kasem Biçoku, Martin Camaj, Zekerija Cana, Egin Ceka, Neritan Ceka, Nathalie Clayer, Konrad Clewing, Krisztián Csaplár-Degovics, Bardhyl Demiraj, Engelbert Deusch, Alain Ducellier, Ferid Duka, Dritan Egro, Robert Elsie, Cecilie Endresen, Winfried Fiedler, Bernd J. Fischer, Iljaz Fishta, Eva Anne Frantz, Konstantinos Giakoumis, Armin Hetzer, Enver Hoxhaj, Ylber Hysa, Hivzi Islami, Rexhep Ismajli, Titos Jochalas, Lumnije Jusufi, Thede Kahl, Hasan Kaleshi, Karl Kaser, Machiel Kiel, Ardian Klosi, Markus Koller, Hans- Jürgen Kornrumpf, Georgia Kretsi, Maximilian Lambertz, Fatos Lubonja, Noel Malcolm, Joachim Matzinger, Beqir Meta, Etleva Nallbani, Hubert Neuwirth, Markus W. E. Peters, Robert Pichler, Arshi Pipa, Alexandre Popovic, Selami Pulaha, Artan Puto, Gilles de Rapper, Skënder Rizaj, Michel Roux, Michael Schmidt-Neke, Gottfried Schramm, Stefanie Schwandner-Sievers, Spiro Shkurti, Georg Stadtmüller, Isabel Ströhle, Milan von Šufflay, Enis Sulstarova, Muhamet Tërnavë, Bernhard Tönnies, Michael Ursinus, Ardian Vehbiu, Xhelal Ylli.

Nathalie Clayer, Konrad Clewing, Krisztián Csaplár-Degovics, Eva Anne Frantz, Idriz Idrizi, Lumnije Jusufi, Ardian Klosi, Markus Koller, Stefanie Schwandner-Sievers, Hansfrieder Vogel dhe Ioannis Zelepos kanë bërë propozime të rëndësishme. Michaela Strauss ka punuar me kujdes dorëshkrimin për botimin në gjermanisht.

Të gjitha interpretimet si dhe gabimet e mundshme janë në përgjegjësi të autorit.

Janë përdorur toponimet e sotme zyrtare. Sipas kontekstit shfaqen edhe trajta më të vjetra si Manastir për Bitolën.

Ky libër u kushtohet atyre lexuesve shqiptarë që dëshirojnë ta njohin historinë e tyre të pasur në mënyrë të mëvetshme, me një ndërvarësi europiano-juglindore dhe mbareuropiane.

Vjenë, tetor 2011

Oliver Jens Schmitt

Bazat e historisë shqiptare

Dy rrugë ofrohen tekefundit për të shkruar një histori të shqiptarëve: më njërën anë historia e një etnie që ekziston prej lashtësisë, që rrjedh prej popullit të lashtë të ilirëve e që pas përpjekjesh të pasuksesshme për krijimin e shtetit dhe pas sundimit të huaj shumëshekullor, arriti në vitin 1912 mëvetësinë e vet shtetërore, ndërkohë që me Kosovën, një shekull më vonë (2008), lindi një shtet i dytë shqiptar. Më anë tjetër: një histori shqiptare si histori Ballkani, në të cilën mund të përshkruhen si nën një lente larmia e copëzimi gjuhësor, kulturor e social i një rajoni të madh europian.

Varianti i parë mbisundon në shoqëritë shqiptare në Ballkan, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme, pasi popujt fqinjë të Europës Juglindore e vështrojnë të kaluarën e tyre në të njëjtën mënyrë. Përfytyrimi i historisë shqiptare dhe identiteti kombëtar shqiptar kanë lindur në kontrast të fortë me popujt fqinjë, sidomos me grekët, serbët dhe malazezët dhe kanë marrë më së shumti si në pasqyrë modelet e tyre të të menduarit. Aq pak sa shqiptarët përbëjnë një përjashtim në Ballkan, po aq pak ndahen interpretimet historike kombëtare të Ballkanit nga një kuadër krahasues mbareuropian. Ajo çka është mburjtur në thelb në Europën Qendrore që prej shek. 19 si përfytyrim për kombin dhe për prejardhjen, vazhdon të jetojë sot në Ballkan nganjëherë më fort se tjetërkund në kontinentin tonë.

Nocioni i dytë, historia shqiptare si histori ballkanike, ndjek konceptin mbizotërues shkencor jashtë Ballkanit, sipas të cilit historia e një rajoni me shtetformime të reja moderne - Serbia u bë autonome më 1815, Greqia sovraane si shtet i parë veç më 1830 - dhe një larmi territoresh të vogla etnike dhe fetare, e cila deri më sot, me gjithë dëbimet dhe shpërnguljet masive, nuk është shkatërruar krejtësisht, nuk mund të shkruhet si një radhitje e njëpasnjëshme historish e shteteve dhe popujve. Ky konceptim përforcohet nga format e larmishme të simbiozës dhe gërshetimit kulturor, fetar dhe shoqëror, përmes të përbashkëtave që, deri më sot, nuk kanë mundur të shuhen nga nacionalizmat shtetërorë, nga strukturat dhe pasuria gjuhësore e deri te kuzhina dhe shijet muzikore; madje edhe vetë modelet e të menduarit të nacionalizmit ngjajnë në këtë rajon në një mënyrë që bie fort në sy.

Historiani kroat Milan fon Shuflaj (von Šufflay), në çerekun e parë të shek. 20, zhvilloi tezën sipas së cilës shqiptarët përbëjnë “monadën e Ballkanit”, meqë në historinë e tyre vjen e bashkohet në miniaturë krejt historia e Ballkanit, që nga lashtësia, me elementet e veta të vjetra ballkanike, greke, romane, sllave dhe osmano-turke. Krishterimi katolik e ortodoks, islami sunit dhe një mbushullim urdhrash dervishësh vijnë e mblidhen këtu së bashku, në një rajon kufitar midis botës ballkanike bizantino-osmane dhe hapësirës adriatike romane, që qe për një kohë të gjatë venedike. Si tezë të dytë Shuflaj skicoi atë të “simbiozës serbe-shqiptare” - e papërfytyrueshme sot për nationalistët e të dyja anëve, megjithatë e dëshmuar mirë nga burimet, sidomos ato mesjetare.

Historia shqiptare si histori Ballkani ravijon mbivendosi shoqërore dhe kulturore midis shqiptarësh e grekësh, sllavësh të Jugut, romanësh të Ballkanit, turqish, po edhe

italianësh, romësh dhe bashkësive mjaft të vogla hebreje. Megjithatë, kjo nuk bën që historia shqiptare të tretet në një rrëfim multietniciteti. Pasi një mënyrë e tillë të menduari, përveçse nuk është e saktë për nga përmbajtja, përshfaq në Ballkan edhe një dimension politik: prej shekullit 19, nacionalistët, sidomos në Greqi dhe në Serbi, ua mohojnë shqiptarëve një histori të vetën dhe i vështrajnë ata ose si një popull barbar pa kulturë, që duhet pushtuar dhe qytetëruar, ose si pjesë të kombit të vet, meqë gjithë ortodoksët shqiptarë “në të vërtetë”, për arsye të besimit të tyre, qenkëshin grekë, ndërsa shqiptarët myslimanë të Kosovës “në të vërtetë” serbë, që janë islamizuar e shqiptarizuar. Nga frika e pretendimeve të tilla, historianët shqiptarë mohojnë identitetin e disafishtë dhe çdo ambivalencë kulturore. Vëzhguesi i paanshëm nuk duhet të ndjekë as mënyrat e të menduarit nacionaliste e as të stepet para ndjeshmërive nacionale, gjithsesi një përpjekje që është më e lehtë për t’u formuluar sesa për t’u zbatuar në dije, përballë emocionalizmit të sotëm, ende shumë të fortë, kur është fjala për historinë e Ballkanit.

Se çka është një shqiptar, kjo sikurse edhe për bashkësi të tjera etnike, është trajtuar e trajtohet gjithmonë në mënyra të reja. Për hir të thjeshtësisë, në paraqitjen tonë do të përdoret emërtimi “shqiptar”, edhe pse ky, në përmbajtjen e tij, ka ndryshuar mjaft përmes shekujve: prej folësit të gjuhës shqipe, që u binte në sy edhe vëzhguesve mesjetarë për veçanësinë e tij, që edhe nga shqiptarët vetë mbahej si shenjë dalluese, herë-herë pa dyshim edhe si dallim prej fqinjëve të tyre më të rëndësishëm, grekëve dhe sllavëve të Jugut - deri te shoqëritë e sotme shqiptare me identitetin e tyre të theksuar etno-kombëtar; një zhvillim që nuk ka ecur aspak në vijë të drejtë ose pa thyerje.

Historia shqiptare, në një krahasim historik ballkanik, por edhe europian, nuk përbën përjashtim - edhe historitë greke, bullgare e serbe duhen shkruar si histori Ballkani, edhe pse shqiptarët në krahasim me këta popuj nuk patën, para vitit 1912, sundime jetëgjata ose organizim të vetin kishtar. Historia shqiptare, e kjo është një nga tezat themelore të këtij libri, është “më normale”, d.m.th. më pak e jashtëzakonshme sesa e perceptojnë shqiptarët, por gjithashtu më pak “ekzotike” sesa pandehin shpesh fqinjët dhe të huajt e tjerë. Ndërkallja në varësi më të gjera do të tregojë se kërkimi për veçanësi kombëtare shumë shpejt bie në zbrazëti, sapo që vështrimi endet pak më larg.

Meditimi mbi historinë shqiptare është i vjetër. Kohë para se të krijoheshin institutet kërkimore shqiptare (prej vitit 1945), dijetarët përëndimorë kanë ngritur teori mbi prejardhjen dhe gjuhën e këtij populli ballkanik - i pari nuk qe askush më pak se Gottfried Wilhelm Leibniz. Përmbledhtazi, por pa ekzagjeruar mund të thuhet se historia shqiptare ka qenë, deri thellë në shek. 19, domen i dijetarëve të gjuhës gjermane. Por askush nuk arriti t'i rrokë aq qartë çështjet themelore të historisë shqiptare saç bëri historiani dhe publicisti i madh Jakob Philipp Fallmerayer (1790-1861), i cili, para 150 vjetësh, bëri këto vëzhgime: në jugperëndim të Ballkanit jeton një popull që ka një gjuhë pa ngjashmëri me gjuhët e fqinjëve. Ky popull veten e quan shqiptar, vendin e tij Shqipëri; kurse të jashtëmit e quajnë “albaner”, “arbaniten” ose “albanese”; hapësira e tij jetike quhet “Albania”, “Arbania” ose “Arbënia”. Jeton në trevat antike Iliri dhe Epir, midis liqenit të Shkodrës në veri dhe gjirit Ambraqik në jug. Në

periudhën antike, ky emër del vetëm një herë në përmendjen e një qyteti (Albanópolis) dhe një malësie (greq. Albanón óros). Në burimet dokumentare shqiptarët shfaqen për herë të parë në shek. 11; si grup që veprojnë së bashku ata na shfaqen në shek. 14, kur emigrojnë në Greqi. Ndahen në dy grupe dialektore, në gegët në veri të lumit Shkumbin dhe toskët në jug të tij. Ata nuk kanë patur kurrë bashkim politik. Shqiptarët jetojnë në zonën e tyre të ngushtë të ngulimit të përzier me popuj të tjerë, por edhe të shpërndarë në pjesë të tjera të Ballkanit. Kanë mbërritur si pushtues dhe ngulimtarë në mesjetën e vonë në Greqi dhe Itali të Jugut. Nuk janë “popull kulture”, *“në fushën e mendimit, përgjatë një ekzistence mijëvojeçare, nuk kanë dhënë as gjënë më të vogël dhe kanë paraqitur kësisoj dëshminë e gjallë se një popull, kur u nënshtrohet vetëm kushteve të përgjithshme të shoqërisë zakonore dhe është njëkohësisht burrëror e luftarak, mund të jetojë edhe pa shkencë, pa arte, madje dhe pa abc e mund ta ruajë fuqinë e vet zanafillore të pazvogëluar deri dhe në mes kombesh me kultivim të lartë”*.

Meditimin e tij themelor mbi historinë shqiptare, Fallmerayer-i e përmbledh në fjali që sot të duken pak të çuditshme me formën e tyre apodiktike: *“Shqiptarët çmojnë kudo qëndrimin në vend, masën e vetëkufizimit dhe konservatorizmin më të ngulmët, siç e kupton atë vetëm Orienti i palëvizshëm, i ngrirë në vetvete. Shqiptarët, sa herë që mund ta shpalosin natyrën e tyre, janë kudo egoistë, rebelë, të paqëndrueshëm e mizorë edhe si të krishterë, nga ana tjetër zejtarë, detarë, bujq e ushtarë energjikë, të patrembur, kursimtarë e rezistentë, të cilëve nuk mund t’ua gjesh anën me ide të përgjithshme, me politikë ndjenjash, me dituri specialisti e me teori filozofike të lumturisë botërore. Askush deri më sot nuk e ka ndjerë në Shqipëri nevojën për të mësuar ndonjë njoftim të sigurt mbi të shkuarën e vet kombëtare. As në politikë e as në dituri nuk ka patur ndonjëherë ky popull një mendim të*

përbashkët e nuk duket se shqiptarët kanë patur ndonjëherë nevojën që të kapërcejnë horizontin e kufizuar të familjes dhe të klanit, të pronës private, të egoizmit, të mllëfit dhe hakmarrjes. Shqipëria është vendi i mendimit të shkurtër, magazina e fuqisë fizike, vendi që me dashje nuk i bindet as vetvetes e as të tjerëve; Shqipëria është elementi që mohon gjithmonë, e ku anarkia dhe mungesa e ligjit janë njëkohësisht shpirt dhe frymë e jetës.”

Tezat e Fallmerayer-it në vështrim të parë duken si një shembull klasik i “orientalizmit”, i ekzotizimit të një populli; cilësitë e tij ai i paraqet si thelbësore, si absolute. Po të ishin njohur më mirë në Shqipëri, ato do t’i kishin shkaktuar autorit një refuzim të gjatë, sikurse pat shkaktuar në Greqi doktrina e tij e prejardhjes sllavo-shqiptare të grekëve të rinj. Fallmerayer-i i shkruante këto rreth vitit 1860, kur reformat osmane (Tanzimati), për të cilat ai pat shprehur simpati të madhe, kërcënoheshin të dështonin edhe nga qëndresa e myslimanëve konservatorë shqiptarë. Ai përcaktoi disa çështje themeltare të historisë shqiptare, që edhe sot e kësaj dite e thithin kërkimin. Një gjë atij i dukej e vetëkuptueshme: që shqiptarët duhen parë në Ballkan si një tërësi. Lufta Ballkanike e vitit 1912 krijoi vërtet një shtet të pavarur shqiptar, veçse gati gjysma e shqiptarëve dhe territoret e tyre të ngulimit iu kaluan sidomos Serbisë, por edhe Greqisë dhe Malit të Zi. Në shek. 20, shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve të shtetit kombëtar morën rrugë të ndryshme. Historiografia, për arsye të ndryshme, ndoqi kufijtë e rinj shtetërorë, duke shpërbërë kështu ndërvarësitë e vjetra. Në vijim do të bëhet përpjekja jo për një histori të Shqipërisë ose të Kosovës, po për një histori të të gjithë shqiptarëve në ndërvarësitë e tyre ballkanike dhe mbareuropiane.

Kur fillon historia e shqiptarëve?

Në këndvështrimin shqiptar, përgjigja e kësaj pyetjeje është e qartë: shqiptarët janë populli më i lashtë i Europës, bashkë me ta nis dhe historia europiane. Në këtë vështrim, historia shqiptare është histori e popullit dhe kjo është e lidhur ngushtë me gjuhën shqipe. Përpara mesjetës së vonë nuk kemi ndonjë dokument që një shqiptar të jetë shprehur për grupin e vet; përpara shek. 16 nuk ekzistojnë tekste të gjata në shqip - libri i parë shqip, përkthimi i një meshari katolik nga Gjon Buzuku (1555) na ka mbërritur në një ekzemplar të vetëm. Përpara vitit 1912 nuk ka patur shtet shqiptar dhe as ndonjë histori politike të përbashkët të shqiptarëve. Ngaqë ata këto fakte, krahasuar me historinë e fqinjëve në Ballkan, i ndjenë si deficite, nacionalistët shqiptarë zhvilluan përfytyrimin e një vijimesie ilire-shqiptare të popullit dhe të gjuhës, që sot merret si një e vërtetë e padiskutuar, por edhe e padiskutueshme. Në një krahasim historik european të bien në sy paralelet me një popull tjetër të vjetër european jo të romanizuar, me baskët, të cilët kanë një histori që shkon deri në fillimet e kohës së re, veç përmes dëshmi-ve të të jashtëmëve, me një gjuhë që u përdor për një libër veç në vitin 1545, me një prejardhje të pasqaruar e të kontestuar ideologjikisht, me një nacionalizëm që mbështetet në kufizimin prej fqinjëve, që janë ndjerë si sipëranë në kulturë dhe politikë, mbi lashtësinë e gjuhës dhe të ngulimit.

Dija jashtëshqiptare përpiqet që në çështjen e vijimesisë të përdorë një qasje më të diferencuar. Historia e lashtë e shqiptarëve është më tepër një problem kërkimor sesa objekt i fakteve të mirëqena. Edhe pse është e mundshme ta përshkruash historinë antike të trevave të sotme të ngulimit të shqiptarëve, e pra historinë e ilirëve dhe të bashkëjetesës

së tyre me ngulimet qytetare greke të bregdetit (prej shek. 7 p.Kr.) dhe pushtuesit romakë (prej shek. 3 p.Kr.), prapë-prapë kjo duhet bërë me rezervën që teza e vijimësisë nuk është e sigurt. Kjo mënyrë trajtimi nuk është e pazakontë: le të kujtojmë përfshirjen e popujve antikë si keltët, madje edhe të popullatave të epokës së re të gurit në përshkrime të zakonshme të Europës Perëndimore. Në rastin shqiptar, çdo ndarje kohore e paraqitjes përfaqëson pozicionim në një debat vijimësie mjaft të kontestuar politikisht. Po të fillosh me lashtësinë, supozon heshturazi vijimësinë ilire-shqiptare. Po të fillosh me shfaqjen e shqiptarëve në dokumentet e shkruara (shek. 11), atëherë shqiptarët shfaqen në Ballkan, krahasuar me grekët, romanët e Ballkanit dhe sllavët e Jugut, si një popull “i ri”.

Gjendja kërkimore lidhur me çështjen e vijimësisë do të përshkruhet më me hollësi. Paraqitja jonë niset nga vlerësimi se shqiptarët e sotëm e kanë prejardhjen nga një popull i vjetër i Ballkanit, d.m.th. një popull që ndodhej në Ballkan përpara sundimit romak. Nëse fjala është për ilirët apo për një popull tjetër të njohur me emër apo ndoshta edhe të panjohur fare, kjo së paku në kontekstin tonë - po jo për vetë shqiptarët dhe fqinjët e tyre ballkanikë! - është me rëndësi të dorës së dytë. Meqë kërkimet gjuhësore e shpien shqipen në antikitetin e parakrishterë, kjo do të thotë se historia shqiptare nuk zë fill me dëshmitë burimore të historiografive bizantine në mesjetën e lartë. Kjo ka dy rrjedhoja: sundimi romak në Ballkan përbën kuadrin historik për paraardhësit e shqiptarëve, ndaj dhe paraqitja jonë e merr parasysh antikitetin, por duke i vënë një theks të veçantë përshkrimin të diskutimit aktual kërkimor lidhur me tezën e vijimësisë.

Periodizimi i historisë shqiptare

Nëse, siç thamë, fillimi i historisë shqiptare nuk është i lehtë për t'u përcaktuar, pika përmbyllëse, koha që jetojmë, nuk paraqet vështirësi të tilla metodike. Mirëpo kjo nuk vlen për ndarjen sipas epokave. "Historia e popullit shqiptar", kjo vepër zyrtare e përfunduar kohët e fundit nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, i ndan katër vëllimet e saj kështu: vëllimi i parë shkon nga lashtësia deri rreth vitit 1830, në fillimet e periudhës së reformës osmane (Tanzimatit), por sidomos në shenjat e para të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare; vëllimi i dytë trajton Lëvizjen Kombëtare Shqiptare deri në themelimin e shtetit shqiptar (1830-1912); vëllimi i tretë përshkruan historinë e shtetit kombëtar shqiptar deri në pushtimin prej Italisë fashiste në vitin 1939; së fundi, vëllimi i katërt shkon deri në rrëzimin e komunizmit (1990/92). Kosova trajtohet këtu si shtojcë e jo si pjesë përbërëse.

Kjo ndarje e pabarabartë e lëndës ndjek klasifikimin e historisë kombëtare sipas katër shtyllash, siç u përpunuan nga historianët komunistë të partisë pas vitit 1945. Këto mbështeten mbi modele më të vjetra të menduari, që lindën aty nga fundviti i shek. 19: 1) ilirët antikë; 2) krijimi i shtetit mesjetar nën heroin kombëtar Skënderbeu (1405-1468); 3) e ashtuquajtura "Rilindja" në shek. 19; 4) krijimi i shtetit në vitin 1912 dhe përkryerja e tij në shek. 20, çka e sjell gjithë historinë shqiptare në një proces teleologjik. Nga historia europiane, historianët shqiptarë kanë marrë epokat e lashtësisë dhe mesjetës. Ndërsa nocionet që përdoren për Europën Perëndimore dhe Qendrore, për fillimet e kohës së re dhe kohën e re, zor se mund të përdoren për periudhën e gjatë të sundimit osman (afërsisht 1385-1912) - diçka që sigurisht nuk e bëjnë as studiuesit shqiptarë e as ata të huaj. Pothuajse pesë

shekuj të sundimit osman kanë lënë vulën e tyre në shoqërinë shqiptare deri më sot, mirëpo në historiografinë shqiptare ata trajtohen si të njerks, shpesh deri dhe në mënyrë negative. Me pushtimin osman vërtet që hapësira jetike e shqiptarëve merr një rrugë më vete - sundimi osman duhet rrokur si një epokë historike më vete, vërtet e ndarë në faza sipas dendurisë së sundimit, por jo e lidhur me zhvillimet perëndimore të fillimeve të kohës së re dhe të kohës së re, sikurse humanizmin, revolucionin e shtypshkronjës, reformën, kundërrreformën, barokun, iluminizmin, industrializimin. Shoqëritë shqiptare të shek. 20 mund të përshkruhen në shumë fusha si pasosmane, pasi që hapësira ngulimore shqiptare u çlirua nga sundimi osman veç para një shekulli. Pa një përshkrim të saktë të periudhës osmane është e pamundur të kuptohen shoqëritë e sotme shqiptare. Ndaj dhe paraqitja jonë e vë theksin te një periudhë paramoderne, që mbërrin deri thellë në historinë e midis dy luftërave. Kështu mund të rroken më mirë strukturat dhe rrymat e thellësive të historisë shqiptare, të cilat i shpëtojnë një vështrimi që kufizohet në të shkuarën më të re.

Alban apo shqiptar?

Shumica e vendasve e quajnë veten sot “shqiptarë”. Me përjashtim të serbishtes, ku fjala “šiptar” përmendet në mënyrë tepër përçmuese (forma korrekte është “albanac”), gjithë popujt e tjerë fqinjë i emërtojnë shqiptarët me fjalë që kanë rrënjën “alb” ose “arb”. Edhe shqiptarët e ngulur në mesjetën e vonë në Greqi dhe Itali të Jugut nuk e quajnë veten “shqiptarë”, por “arvanitë”, përkatësisht “arbëreshë”. Si shpjegohet kjo dukuri? Në mesjetë shqiptarët njihnin si emërtim të etnisë së vet veç fjalën “arbër”, hapësirën

e tyre ngulimore e quanin “Arbëria” ose “Arbënia”. Kjo rrjedh nga emri i fisit “albanoi” që dëshmohej pak në antikitet. Është e paqartë se si dhe nëse shqiptarët e kanë marrë këtë fjalë nga një etnikum tjetër. Marrja e një emërtimi të tillë të vjetër populli ose vendi nuk do të ishte diçka e çuditshme. Në mesjetën e lartë, kolonët gjermanë morën emrin e prusëve që i patën nënshtruar (prusianë).

Ndërkohë që origjina e emrit të popullit është e vështirë të qartësohet, për ndërrimin nga “arbër” në “shqiptar” kemi disa pak burime të shkruara. Lënia e emrit të vjetër të popullit ndodhi mjaft vonë, rreth viteve 1700, çka përbën, së paku në këtë këndvështrim, një veçanti europiane.

Përse ka marrë një grupim i madh emër të ri? Shoqëria shqiptare u trondit thellë nga pushtimi osman, i cili zgjati një shekull (1385 - afërs. 1500) e në vise të caktuara shkaktoi shkatërrime të mëdha dhe humbje popullsie. Në shek. 16, sidomos në atë 17, shumë shqiptarë përqaftuan islamin. Emri “arbër” ishte i lidhur ngushtë me kulturën mesjetare të krishterë e cila u mënjanua nga islami. Shqiptarët e islamizuar, si bartës të pushtetit osman në Ballkan, filluan ta shmangin gjithmonë e më shumë një emër që kujtonte të shkuarën e krishterë. Nocioni “shqiptar” (pas gjasave prej foljes “shqiptoj”, “flas qartë”) u përhap dalëngadalë në trevën e mbyllur gjuhësore në Ballkan - pa dyshim në shek. 18 - edhe te të krishterët shqiptarë, duke shërbyer si kufizim ndaj popujve me gjuhë të tjera. Por ai nuk përfshiu bashkësitë që ishin jashtë trevës bazë ngulimore, në Greqi dhe Itali të Jugut. Ndërsa popujt përreth - me përjashtim të serbëve të thurur ngushtë me “shqiptarë” - nuk e bënë ndërrimin e emërtimit, po të përjashtojmë këtu fjalët e modës së vjetër si “skipëtar” (që u bë e njohur sidomos nga libri i Karl May-t “Nëpër vendin e skipëtarëve”). Asnjë popull tjetër europian i

kohës së re nuk ka kryer nën shokun kulturor një ndryshim të tillë rrënjësor të identitetit: “shqiptar” shprehu orientimin krejtësisht të ri të shoqërisë shqiptare, e cila deri më 1912, në shumicën e saj dërrmuese, e kishte drejtuar vështrimin për nga Stambolli, kryeqendra e Perandorisë Osmane.

*Historia shqiptare në hapësirë:
rrudhje apo madhësi e ndryshueshme?*

“Për ta (shqiptarët) gjithë vendi që përfshin prej Shkodre në Shqipëri qarqet e Pejës, Prishtinës, Vranjës, Kaçanikut, Shkupit, Përlepit, Manastirit, Follorinës, Grevenës, Kalaritit, Janinës e deri në Gji të Prevezës dhe vendi që kufizohet nga këto pika gjeografike dhe deti, është Shqipëri; një vend që i përket racës shqiptare, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me Greqinë.”¹

Me këto fjalë e skicone katoliku nga Shqipëria e Veriut dhe nëpunësi osman Pashko Vasa në vitin 1879 programin hapësinor të Lëvizjes së re Kombëtare Shqiptare. Ai përfshinte territoret e sotme të Shqipërisë, Kosovës, Serbisë Jugore, pjesë të Maqedonisë si dhe Greqisë Veriperëndimore, të kufizuara në mënyrë simbolike nga Shkodra në veriperëndim, Vranja në verilindje, Përlepi dhe Manastiri në lindje dhe Preveza në jug. Si një “Shqipëri e katër vilajeteve” (provincat e mëdha osmane Kosovë, Manastir, Janinë dhe Shkodër) ai përcakton deri më sot të menduarit hapësinor të nacionalizmit shqiptar. Mirëpo, qysh në vitin 1897, ky përfytyrim i përgjigjej më tepër një dëshire sesa realitetit - nga njëra anë për arsye se territori i Vranjës u pushtua më 1877 nga Serbia

1) Kemi të bëjmë me vende si më poshtë: Shkodra (Shqipëria e Veriut sot), Peja, Prishtina (të dyja në Kosovë), Vranje (Serbia Jugore sot), Kaçanik (Kosovë), Shkup, Prilep, Manastir (të tre në Maqedoni), Florina, Grevena, Kalarites (pranë Janinës), Janina, Preveza (Greqi).

dhe “u pastrua etnikisht” pothuajse në krejt sipërfaqen nga myslimanët shqiptarë; nga ana tjetër për arsye se në këtë hapësirë shqiptarët përbëjnë shumicë të qartë vetëm në territoret bazë, të cilat në thelb i përgjigjen Shqipërisë së sotme dhe pjesëve të Kosovës. Një Shqipëri homogjene etnikisht ka ekzistuar para vitit 1912 po aq pak sa bie fjala një Bullgari “e pastër” etnikisht - mirëpo homogjeniteti etnik prej pjesës së fundit të shek. 19, ashtu si në shtetet fqinje, u zhvillua në një model mbisundues politik. Dhe ky model u lidh me përfytyrimin e vijimësisë iliro-shqiptare. Meqë ilirët në lashtësi jetonin prej hapësirës së Alpeve lindore deri në kufi të Greqisë antike - jo si popullatë homogjene, por të përndarë nëpër fise dhe mbretëri të vogla të shumta - ndërsa shqiptarët e shek. 20 zënë vetëm një pjesë të kësaj hapësire shumë të madhe, për të shpjeguar këtë dallim lindi teza e rrudhjes së hapësirës ngulimore shqiptare: sipas saj, prej lashtësisë, fqinjët armiq - grekë, romakë e sllavë - i kanë zmbur hap pas hapi shqiptarët. Nganjëherë, për shembull në librat e shkollës, aludohet për gjenocide ahistorike në tentativë, që kanë patur për viktima shqiptarët, të cilët vetë, prej mijëvjeçarësh, nuk kanë sulmuar askënd. Çdo pretendim i sotëm territorial shqiptar në këtë këndvështrim mund të shihet si rritim i përligjur i territoreve të humbura padrejtësisht.

Vetëparaqitja si viktima të historisë në Ballkan e përtej tij, pa dyshim nuk është një specifikë shqiptare, mirëpo për shkak të përmbysjeve politike të njëzet vjetëve të fundit, teori të tilla fshehin në vetvete rrezikun politik që mund të përligjë veprime agresive duke iu referuar statusit vetjak prej viktime. Sidomos historianët serbë nisen prej një teorie krejt tjetër: sipas saj, shqiptarët kanë depërtuar prej pjesës së fundit të shek. 17 nga Shqipëria e sotme Veriore drejt Kosovës (dhe Maqedonisë Perëndimore), pasi që një kryengritje

e dështuar e vitit 1690 i detyroi dhjetëra mijë serbë të merrnin arratinë drejt territoreve habsburge. Janë të shumtë historianët dhe gjuhëtarët jashtë rajonit që e hedhin poshtë këtë teori, veçse ata ngrenë dyshime në tezën shqiptare të vijimësisë së pandërprerë të ngulimit.

Paraqitja jonë dëshiron që ta bëjë të dukshme dinamikën hapësinore të historisë shqiptare në Ballkan. Ajo nuk orientohet pas kufijsh të palëvizur të ngulimit apo hapësirës, të cilët as nuk mund të përvijohen, por punon me hapësirë variabël dhe zona të gjera mbishtresimesh. Kështu, ajo merr parasysh arumunët (vllëhtë), sllavët dhe grekët, si dhe grupe më të vogla, sikurse turqit, hebrenjtë, romët, boshnjakët, çerkezët, në një hapësirë me shumicë shqiptare, por edhe shqiptarë në një mjedis me shumicë joshqiptare. Hapësira e marrë në vështrim ndahet në dy gjysma prej një vargu malor. Ndaj do të flitet për territore “në perëndim të maleve”, kur është fjala për territorin e Shqipërisë së sotme dhe rajonin e gjerë të mbivendosjes shqiptaro-sllave në Shqipërinë e sotme Veriore dhe Mal të Zi, si dhe zonën e përzier greke-shqiptare-arumune në Shqipërinë e sotme të Jugut dhe Epir. “Territoret në lindje të maleve” përfshijnë Kosovën dhe Maqedoninë e sotme Perëndimore, por edhe praninë shqiptare, përkatësisht lidhjet në pjesën e sipërme të Moravës (Serbia e sotme Jugore) dhe pellgun e Vardarit (Maqedoni, Greqi e Veriut). Edhe në qoftë se trajtohen territore më së shumti joshqiptare në varësi të historisë shqiptare, kjo nuk do të thotë që ato përfshihen në një mënyrë të treguari nacionaliste shqiptare apo shqiptaromadhe. Përkundrazi, kjo mënyrë procedimi dëshiron të theksojë karakterin ballkanik të së kaluarës dhe, edhe pse të dobësuar nga nacionalizmi në krejt rajonin, të së tashmes shqiptare.

*“Shqipëria” si koncept hapësinor
- ose si quhet vendi i banuar prej shqiptarëve?*

Për të kuptuar përmasën hapësinore të historisë shqiptare duhet marrë për pikënisje vëzhgimi i Fallmerayer-it: “Shqipëria është një peizazh historik ku jetojnë jo vetëm shqiptarë; në të njëjtën kohë shqiptarët janë të ngulur edhe jashtë hapësirës së quajtur Shqipëri.

Emri pak i dëshmuar në lashtësi “Albania”, rishfaqet në shek. 11 si emërtim i një grupi etnik - albanoí ose arvanítaj, rreth vitit 1100 dhe si emër vendi - greqisht Arbanón, pak më vonë latinisht si Albanum dhe serbisht si Raban (emri i popullit është “arbanas”), në *Këngën e Rolandit* si “Albeigne”. Arbanoni përfshinte në fillim territorin e Shqipërisë së sotme të Mesme dhe kështjellën me rëndësi strategjike të Krujës. Midis viteve 1100-1400 ky koncept hapësinor u shtri më tej deri në Kotorr (në Malin e Zi të sotëm) në veri dhe në Naúpaktos (Greqi) në jug. Cilat ishin arsyet? Emrat e vendeve lidhen dhe me sundimet. Nëpërmjet krijimit të sundimit shqiptar në Epirin e Jugut (gjysma e dytë e shek. 14) shqiptarët ranë në sy si një grup mbisundues në një mjedis me shumicë joshqiptare. Në veri, Venediku i kishte përmbledhur në fillim të shek. 15 qytetet e nënshtruara prej tij midis Lezhës dhe Kotorrit, në një qark juridiksioni të quajtur “Albania”, një emër që nuk pasqyron popullatën e përzier shqiptaro-sllave-dalmate-arumune. Nocionet administrative kanë jetëgjatësi dhe “Arbëria venedike” jetoi edhe pas humbjes së qytetit të Shkodrës (1479) deri më 1797 si emërtim për vendet sllavo-jugore midis Budvës dhe Kotorrit. Në jug u ngulit emërtimi “Albania”, “Arvanitiá”, “Arbëria” si një nocion i vagullt hapësinor për Shqipërinë e sotme të Jugut dhe Epirin.

Emërtimi antik “Epir” në mesjetë ishte zhdukur e u gjallërua veç aty nga fundi i shek. 18 nga gjeografë grekë, në fillim paralel me “Albania”. Vetëm në shek. 19 e sidomos të 20 të dyja këto nocione morën një kuptim nacional: Epiri paraqet pretendimin për një territor me shumicë greke, që kthehet në program irredentist pas vitit 1912 për Shqipërinë e sotme të Jugut të quajtur “Epir i Veriut”.

Midis shek. 15-17, prej klerikësh katolikë shqiptarë u përdor përkufizimi hapësinor sipas traditës antike “Maqedoni”, që edhe sot ka dalë nga përdorimi. Ndërsa osmanët përdorin emërtimet “Arnavutluk” ose “Arnavut-ili”. Emërtimi “Shqipëria” që përdoret sot nga shqiptarët, erdhi e u përforcua dalëngadalë prej shek. 18 dhe gjeti përdorim të gjerë ndër aktivistët kombëtarë të shek. 19. Kulti ilir i shek. 20 i shtyu pjesë të elitave, sidomos në Kosovë, që të bënin një propozim, tekefundit të dështuar, për ta zëvendësuar emërtimin serb të vendit me atë ilir “Dardania”.

Historia shqiptare jashtë “Shqipërisë”

Pjesa e dytë e vrojtimit të Fallmerayer-it - që shqiptarët nuk jetojnë vetëm në hapësinën “Shqipëri” të përzier etnikisht, por të banuar kryesisht prej shqiptarësh, porse edhe jashtë saj - është e saktë për zonat ngulimore shqiptare në brendësi të Ballkanit. Klerikë katolikë shqiptarë e emërtonin në shek. 17 Kosovën, që asokohe qartazi bashkëbanohej nga shqiptarë, si “Serbi”. Edhe këtu emërtimin e diktonin sundimi dhe tradita e sundimit. Meqë në periudhën paraosmane në Ballkanin Qendror nuk ka pasur ngritje sundimesh shqiptare, kisha katolike i merrte emërtimet e veta hapësinore nga historia mesjetare e sundimeve, në këtë rast nga Mbretëria e prënduar Serbe dhe nuk orientohej pas marrëdhënieve

aktuale etnike. E pra, ngulimet shqiptare në Kosovën e sotme, në Serbi të Jugut dhe në Maqedoninë Perëndimore ekzistonin prej kohësh, përpara se të shtrihej në këto treva nocioni hapësinor “Shqipëri”. Këto vërejtje tregojnë se është tepër e vështirë ta përkufizosh edhe hapësirën e ndërvarur ngulimore të shqiptarëve, që ata gjithmonë e kanë ndarë me bashkësi të tjera etnike. Historia shqiptare është në një masë të madhe edhe historia e lëvizjeve migratore në largësi të mëdha: drejt Greqisë (shek. 14), Italisë së Jugut (shek. 15), në grupe më të vogla në thuajse të gjitha rajonet e Europës Juglindore, në provincat lindore të Perandorisë Osmane (Anadoll, Egjipt, Jemen), në rajonin e Detit të Zi (shek. 18), në Amerikë (prej fundit të shek. 19), në Europën Qendrore dhe Veriore (prej viteve 1960), si edhe një herë në mënyrë masive drejt Greqisë dhe Italisë (prej vitit 1991). Këto bashkësi diaspore, si rregull, nuk i kanë shkëputur lidhjet e tyre me viset e prejardhjes, përkundrazi, ato u kanë dhënë vulën e tyre pjesëve të rëndësishme të historisë shqiptare në Ballkan. Kësisoj historia shqiptare është edhe një histori transnacionale, e thënë më saktë: transterritoriale; ajo është e gërshetuar me historinë e Ballkanit dhe të hapësirës më të gjerë mesdhetare, e zgjeruar në shek. 20 edhe me përmasa atlantike. Sa më larg që ajo shkon jashtë Ballkanit, aq më vështirë është të kufizohet brendapërbrenda tij.

Kuadri natyror i historisë shqiptare

“Shqipëria është një vend i mbyllur prerazi; nga fqinjët e vet ndahet prej kufijsh natyrorë të mprehtë, thuajse pa zbrazëti; mirëpo veç në këtë mbyllje të rreptë nga jashtë, vendi mund të shikohet si një tërësi; në vetvete ai copëzohet në shumë ngastra që renditen pranë njëra-tjetrës si gjymtyrë sistemesh të ndryshme më të mëdha,

më tepër në mënyrë rastësore sesa të domosdoshme, duke mos patur një qendër të përbashkët e ndërvarezi organike.”

Johann Georg von Hahn (1811-1869), konsull austriak në Janinën epirote dhe në Siros të Detit Egje, themelues i albanologjisë, në këtë skicë të ngjeshur bashkon tiparet themelore të historisë shqiptare: ndarja e fortë e hapësirës nga vargje malore dhe karakteri i vogël rajonal i shoqërisë shqiptare që rezultoi prej saj. Vargmale që *shtrihen* nga veriperëndimi drejt juglindjes e në perëndim përmbyllin një zonë bregdetare anë Adriatikut, në formë gjysmëhëne, ndërsa drejt lindjes hapen në sistemet lumore të Vardarit dhe Moravës, përbëjnë shtyllën kurrizore të historisë shqiptare në hapësirë. Kjo ndahet në një pjesë adriatike dhe një brendaballkanike. Shqiptarët nuk janë popull i pastër malor, megjithatë malet luajnë një rol vendimtar në të shkuarën e tyre. Vargu i madh malor ndahet më tej nga një numër vargjesh më të vogla prej perëndimit drejt lindjes. Kështu krijohen hapësira luginore me madhësi të ndryshme, si ato të Matit ose Dibrës; vargje malore horizontale dhe vertikale vijnë e mblidhen te masivi i Sharrit në trekëndëshin e sotëm Shqipëri-Kosovë-Maqedoni. Në veri, në kufi me Malin e Zi, ngrihet Malësia e Madhe. Vargmalet horizontale e pengojnë qarkullimin. Për këtë arsye, lidhjet veri-jug duhet të mënjanojnë malet ose nëpër ultësirën bregdetare adriatike, ose nëpër hullitë Moravë-Vardar (Maqedoni dhe Kosovë e sotme). Jo më kot dialektet shqiptare përndahen në një numër variantesh që shkojnë prej jugut drejt veriut: faqet malore i mbyllin ato në mënyrë horizontale, të çarat ekzistojnë më shumë drejt perëndimit dhe lindjes.

Është një rrugë e vetme e madhe që përshkon Shqipërinë historike në drejtimin perëndim-lindje: Via Egnatia, zgjatimi në periudhën romake, përgjatë lumit Shkumbin (Genusit